

Fjala e kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Hivzi Islami, e mbajtur më 24. 04. 2013, me rastin e dorëzimit të Fletëdëshmisë të anëtarit të jashtëm të ASHAK-ut

Kolegë dhe miq të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Na ka tubuar sot profesori, eksperti i shquar dhe organizatori i madh i veprimtarisë shkencore dhe akademike, miku ynë i respektuar, dr. Alajdin Abazi, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, tashmë anëtar i jashtëm edhe i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i cili, me propozim të Seksionit të Shkencave të Natyrës, të aprovuar njëzëri nga Kryesia e ASHAK-ut, u zgjodh në Kuvendin e 5 dhjetorit, 2012.

Do të kemi rastin t'i dorëzojmë sot **FLETEDËSHMINË e anëtarit të jashtëm** të Akademisë sonë dhe njëkohësisht të ndjekim ligjëratën e tij.

Akademik Alajdin Abazin e njohim pothuajse të gjithë, jo vetëm për kontributin e shquar në fusha të caktuara të shkencave teknike dhe kryesisht të teorisë dhe të inxhinjerisë elektroteknike, por edhe si mbështetës dhe pjesëmarrës të zellshëm në konferenca shkencore, në tryeza, në diskutime, në përrurime dhe në aktivitete tjera që organizojnë institucionet shkencore dhe akademike të Kosovës. E kemi konsideruar gjithnjë si pjesë të mjedisit tonë, prandaj dhe zgjedhja e tij anëtar i jashtëm i Akademisë sonë u prit dhe u vlerësua lart në qarqet shkencore-hulumtuese, akademike dhe intelektuale të Kosovës dhe më gjerë.

Ishte ndër kuadrot e para të Fakultetit Teknik në fushën e Teorisë elektroteknike dhe dekan i tij. Pastaj profesor i Fakultetit të posathemeluar Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës dhe një ndër kuadrot aktive në zhvillimin akademik të UP-së që nga themelimi i tij. Në vitet e 80-ta, krahas punës akademike, ushtroi dhe detyrën e drejtorit të Institutit për hulumtime shkencore dhe zhvillim "Inkos" në Obiliq dhe të anëtarit të Bordit për zhvillim të Elektroekonomisë së Kosovës. Ishte anëtar i Bordit Jugosllav-Amerikan i Kooperatës për shkencë dhe hulumtim. Ishte i ftuar si vizitor, por edhe ligjërues dhe hulumtues në universitete të ndryshme ndërkombëtare, si në Universitetin North Wales të Britanisë së Madhe, në Jashi të Rumanisë, në universitetet shtetërore të Tiranës e të Pekinit, në Gjermani, Austri etj. I rëndësishëm ishte qëndrimi i tij studimor në Universitetin West Virginia të SHBA-ve në kuadër të programit të Fulbrajtit

në fillim të viteve të 80-ta dhe pas dhjetë vjetësh edhe në Departamentin e Energjetikës (DOE) të SHBA-ve.

Në vitin 2001 profesor Abazi ushtroi detyrën e drejtorit të Fondacionit të Universitetit të EJK-it në Tetovë. Pastaj u zgjodh dhe Rektor i këtij Universiteti, ku qëndroi për dhjetë vjet rresht, deri në vitin 2010, kur u shpall **Doctor Honoris Causa** dhe **Rektor Emeritus**.

Puna shkencore dhe profesionale e Akademik Alajdin Abazit është multidisiplinare. Nisur nga publikimet, ligjëratat, prezantimet dhe projektet shkencore, në veprimtarinë e tij mund të veçohen këto lëmi: Elektroteknika teorike, Materialet elektroteknike, Energjia dhe mjedisi dhe Arsimi i lartë. Ai ka publikuar një varg punimesh shkencore e profesionale dhe disa tekste universitare për nevoja të studentëve. Ka marrë pjesë në një numër të madh të projekteve shkencore-hulumtuese në Kosovë, në Maqedoni dhe më gjerë.

Pengesat e pushtetit serb për ta mënjanuar si pedagog, shkencëtar dhe hulumtues, sikurse të gjitha kuadrot shqiptare në Kosovë në vitet e 90-ta, nuk patën të ai ndikim demoralizues e frustrues. Përkundrazi, prof. Abazi gjeti forcën dhe vullnetin për të vazhduar punën dhe për të kontribuar në jetën akademike, shkencore dhe shoqërore në mjediset shqiptare në Maqedoni dhe veçanërisht u shqua në çështjet organizative rreth formimit dhe ngritjes së Universitetit të EJK-it në Tetovë. U zgjodh anëtar i MANU-së, i dyti nga radhët e shqiptarëve, që na nderon dhe ne si miq e kolegë të tij dhe i nderon edhe shkencat teknike dhe elektroteknike, por edhe çështjen shqiptare. Na kujtohet qëndrimi kritik i prof. Alajdinit ndaj Enciklopedisë së Maqedonisë, në të cilën fyheshin rëndë shqiptarët, që ndikoi në tërheqjen e saj dhe hartimin e Enciklopedisë së re.

Me të marrë lajmin për zgjedhjen e tij anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, akademik Alajdin Abazi deklaroi: “Kjo zgjedhje ka një domethënie të veçantë për mua, pasi me dekada të tëra kam qenë profesor në Universitetin e Prishtinës. Unë e kam pranuar me shumë kënaqësi zgjedhjen time dhe kjo është një mirënjohje e madhe për mua”.

Më lejoni në fund, kolegë dhe miq, t’i uroj akademik Alajdin Abazit shëndet të plotë dhe jetë të gjatë, duke pritur angazhime, punë dhe vepra të reja, të frytshme shkencore, të rëndësishme për shkencat teknike dhe shkencën në përgjithësi, dhe ta ftoj të marrë **Fletëdëshminë e mirënjohjes** sonë për punën e tij, duke e zgjedhur anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe t’ju ftoj të ndjekim bashkë ligjëratën inauguruese me titull *“Konceptet e rrjeteve emergjente inteligjente dhe kualiteti i fuqisë”*.